

Natasha SHUTERI QI

GJEDHE FJALËFORMUESE TE NEOLOGJIZMAT E LASGUSHIT

Hyrje

“Pasura e fjalorit në vetvete nuk paraqet asnjë vlerë. Hapësira e fjalorit varet nga qëllimi estetik që organizon veprën.”¹

Në mënyrë të përgjithshme ky pohim i Kunderës na tregon se fjala nuk është fonetikiisht kaq e pavarur sa të mund edhe të humbasë në vijueshmërinë e kanalit të të folurit. Dhe nëse në këtë kontekst Galdi do të na tërhiqte veshin duke na kujtuar në të kundërt fjalën në frëngjisht *e cila krijon herë-herë një lloj rrëshqitjeje ndërsa shqiptohet (je n'irai jamais avec vous a Paris)²*, përkundrazi fjala shqipe, edhe e veçuar, duke patur një theks të ngulitur, dallon secilin tingull në brendësi të vargut të tingujve dhe, ndonëse në nëndialektet e saj ajo luan me ë-në e patheksuar, një varg tingujsh formon një grup fonetikiisht shqip, i cili e ka nominuar atë *motra e çuditshme e Indoevropianishtes³*, pra ky varg tingujsh shqip, nga këndvështrimi i vijueshmërisë dhe i pavarësisë së fjalës, përbën gjedhen dhe tulin nga ku do të mbruhet hapësira e fjalëkrijimeve me qëllime të qarta estetike dhe stilistike të njërit

¹ Kundera, M., *Testamentet e tradhëtuaras*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë 2011, f. 118.

² Galdi, L., *Introduzione alla stilistica italiana*, Patron Editore, Bologna 1984, f. 64.

³ https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_shqipe

prej poetëve më bashkëpunues me këtë gjedhe, Lasgush Poradeci⁴.

Të qëmtoosh në këtë hapësirë të krijimtarisë së poetit, do të thotë të startosh vonë, pasi një numër i konsiderueshëm studiuesish e kanë thënë fjalën e tyre, e cila ka zënë vend, duke e bërë shterues kërkimin me fokus fjalët e reja që Poradeci ka sjellë në fondin e leksikologjisë dhe stilistikës shqiptare, si dhe rrugën që ai zgjodhi *si mjet për pasurimin e fjalorit shqiptar*, siç pohon Kuteli⁵.

Po ashtu, nuk mund të jemi më pohues për vlerën shprehëse të fjalës së Lasgushit, përveçse duke iu referuar Qoses kur thotë se *Lasgushi identifikon gjuhën me zjarrin dhe kërkon efektet e saj më të fuqishme*⁶. Të qëmtoosh mes analizave mbi fjalorin e poetit, do të thotë të gjes alternime të spikatura mes problemeve të poezisë së tij me ato të gjuhës dhe arritjeve stilistike të fjalës, të cilat S. Hamiti *i identifikon me ato të Naimit*⁷; të qartësosh lidhjet mes leksemave kyçe dhe mënyrës së formimit të tyre, në të cilat *fjalëformimi jo pak herë ka ndihmuar procesin e ekspansionit dhe kondicionimit*⁸, siç pohon E. Gjikalj; të evidentosh dhe pranosh pa dyshime shtresimin tipologjik semantiko-strukturor të fjalëve të reja, sipas klasifikimeve të L. Topçiu⁹.

Por sfidues për punimin tonë është vlerësimi i përfitesave ligjërimore të arrira nga fjalëkrijimet e Poradeci, duke patur si startim analizat e mirëfillta konkrete tekstore, kryesisht stilistike dhe pragmatike, të ofruara si variante të lexuari të tekstit (ndër to edhe të Poradeci). Kthehen në motivuese ato analiza në të cilat synohet rikuptimësimi i fjalës së poetit, përgjatë leximit të tekstit dhe reflektimit estetik pas leximit të tij, sjellë në një

⁴ Në punimin tonë i jemi referuar veprës letare “Lasgush Poradeci”, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë 1990.

⁵ Kuteli, M., *Poeti Lasgush Poradeci, Vëzhgim kritik*. 1937.

⁶ Qosja, R., *Dialogje me shkrimtarë*, Rilindja, Prishtinë, 1979.

⁷ Hamiti, S., *Vdekja e nositit*. Parathënie, Rilindja, Prishtina 1978.

⁸ Gjikalj, E. *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradeci*, Zambaku botime, Tiranë 2014.

⁹ Topçiu, L., *Tekstualizim dhe stil*, Getic, Bukuresht 2003.

bashkëkohësi të posaçme me prurjet e shkencave të ligjërimit nga Plangarica¹⁰.

Metodologjia

Analizat që referuam më lart na mundësojnë një bazë të mirë teorike dhe praktike, për të drejtuar studimin tonë në hulli analizash tekstore / diskursive, në të cilat qasja do të nisë nga njësitë maksimale tekstore e mbisegmentore, për të zbritur drejt leksemave që *ia dedikojnë* vlerat e tyre stilistikore mënyrave fjalëformuese shumëngjyrëshe. Vlerësimi dhe nxjerrja në pah e mjeteve dhe mënyrave fjalëformuese të një tipologjie të caktuar leksikore, do të na ndihmojë të rivlerësojmë aspektet semantike brenda leksemave, duke e ngushtuar punimin vetëm te kjo tipologji, nëpërmjet qartësimin të semave dhe përbërësve të rinj kuptimorë që fitojnë ato. Dhe së fundi, do të përpiqemi të hedhim dritë, specifikisht në disa nga treguesit e simbolizmit tingullor të poetit, në përpjekje për të përcaktuar *gjedhet* që qëmton e përfton Lasgushi.

Termi *neologjizëm* do të thotë një fjalë e re që pasuron leksikonin e një gjuhe. Në dëshirën për ta përshtatur në strukturën e shqipes këtë term, si dhe në jehonë të qëllimit të Lasgush Poradecit për ta pasuruar gjuhën shqipe me fjalë e kuptime të reja, do të zgjedhim të përdorim termin *fjalëkrijim* për *neologjizëm*. Përmes fjalëkrijimit një formë e re, një koncept i ri, një hije tjetër mendimi arrin të transmetohet me përpikëri nga dhënësi i një mesazhi. Fjalët e marra nga një gjuhë e huaj ose ato që rrjedhin nga fjalët tashmë ekzistuese në një gjuhë mund të konsiderohen së bashku fjalë të reja, megjithatë parapëlqejmë t'i quajmë kredi të parat dhe vetëm të dytat fjalëkrijime të vërteta.

Mund të dallohen dy kategori të fjalëkrijimeve: *fjalëkrijime semantike*, që nënkupton një ndryshim kuptimi edhe nëse forma mbetet identike dhe *fjalëkrijime kombinuese* të cilat vijnë nga ndërthurja e elementeve gjuhësore, përmes proceseve të formimit të fjalëve (*me prapashtesë, parashtesë, prejardhje,*

¹⁰ Plangarica, T., *Shkencat e ligjërimit dhe teksti poetik*, INALCO 2017.

përbërje). Fjalëkrijimet kombinuese janë *një metodë prodhuese*. Deri një folës i zakonshëm që zotëron një leksik të pasur, si dhe ka aftësinë të përdorë saktë mjetet gjuhësore, mund të kuptojë dhe krijojë një seri fjalëkrijimesh kombinatorë. Denduria e përdorimit të këtyre fjalëkrijimeve më pas varet nga funksionaliteti dhe domosdoshmëria e fjalës së re të krijuar, nga valenca që i ka dhënë autori (ose autorët) gjatë përdorimit, nga gjykimi pozitiv i grupeve të kualifikuara, siç janë folësit e ligjërimit libror.

Përmbledhurazi, fjalëkrijimet në përgjithësi duhet të nënkuptohen si veprime të shkrintarit mbi vetë gjuhën. Në kohën kur Lasgushi nisi udhën si poet i letrave shqipe, pra në fillimshkullin XX, prurja e fjalëve të reja në gjuhësi ishte e shtrirë në gjithë Europën, sepse në fakt ky proces ishte tendenca e epokës (më 1911 kishte dalë dizertacioni i Spitzer mbi neologjizmat e Fransua Rabëlesë - François Rabelais) dhe fusha në të cilën diskutohej purizmi i një gjuhe në sensin e parapëlqimit të saj për derivim apo kompozicion.

Jo thjesht si njohës i tendencave të epokës kur po shkruante, por edhe si njohës i mirë i dhembjeve leksikore të gjuhës që e deshi aq shumë, Poradeci punoi mbi gjuhën, duke e trajtuar atë në një tjetër dimension nga bashkëkohësit e tij: Poradeci krijoi një dialogim fin dhe përmbushës mes tingullit dhe kuptimit, fjalës dhe ngjyrimit të saj, thënies dhe kontekstit.

Ngarkesa e fjalës *pleqërishte*

Nisma e të tria këtyre ngarkesave njëherazi (tingullit dhe kuptimit, fjalës dhe ngjyrimit të saj, thënies dhe kontekstit) shfaqet te fjala *pleqërishte* dhe elementi i nënbashkësisë së saj *pleqërish*. Për ta zgjeruar dhe konkretizuar pohimin tonë, do të krijojmë një fushë leksemash dhe semash, të cilat zënë fill dhe përmyllën tek mbiemri *pleqërishte*, trajtuar në kontekstet e saj përdorimore dhe stilistikore.

- a) *Po lëngon e nis të shembet folja jonë pleqërishte* (f. 74);
- b) *Gjuhë e ëmbël e stërgjyshëve do të dukej gjuhë e vdarë: / humbi radhën çdo të folur, çdo kuvend e ndyti shijen / Ligjërata pleqërishte sot ka vlarë vetëdijen*. (f. 73);

- c) *O këngë pleqërishte! Ti vjershë e vendit tem!* (f. 63, 65);
d) *Sa për shqipen pleqërishte- për çudinë e mosfjalosur / vesh i tyre-i shushulluar ka timpanin e rrëxhosur* (f. 77);
e) *E si ra në qetësi / si shkoj kënga për liri / pasi shkoj e zë më s`kishte / ajo kënga pleqërishte:/asnjë zë më s`doli fare / përmbi tokën shqipëtare* (f. 99).

Sintagmat e evidentuara janë: *folja pleqërishte, ligjëratë pleqërishte, këngë pleqërishte, shqipe pleqërishte, kënga pleqërishte*. Në vëmendjen tonë është fjala *pleqërishte*, kuptimi i së cilës rroket vetëm brenda thënieve që ne shkëputëm të plota në synimin e tyre kumtues. Sintagmat krijojnë një fushë semantike dhe sema e tyre e përbashkët brenda secilës nga thëniet, orienton një dhe një vijueshmëri logjike të vetme: *e folur, ligjërim, e kënduar*¹¹, *komunikim shqip* duke krijuar në këtë mënyrë korpusin komunikues verbal të një shqipfolësi. Duke e konceptualizuar procesin e abstragimit të korpusit semantik që përmendëm, akti komunikues tradicionalizohet nga poeti në një prerje të sfondit historik kur ai shkroi, me ndjesitë që ky moment induktoi në vetëdijen e tij poetike, dhe nis kështu një marrëdhënie e realitetit objektiv në një kohë x (*kohë e cila përmbledh bashkë këto presupozime pragmatike: a) dëmi shkaktuar gjuhës shqipe, b) vetëvlerësimi mohues, keqardhës; c) kompleksiteti ndjesor i isos labe; d) madhështia e gjuhës së munguar; e) motivi i lirisë*) me serinë e ndjesive që ngacmohen në vetëdijen poetike dhe mbishtresohen në një imazh të vetëm, përmbledhës. Që ta qartësojmë këtë imazh përmbledhës, duhet më së pari të ravijëzojmë prerjen që ndodh midis dijës (dinamika e realitetit objektiv që numëruam më lart) me vetëdijen¹² poetike të Lasgushit (kompleksiteti i ndjesive që

¹¹ Në këtë rast duhet të sqarojmë se e njëjta shenjë na qas dy shenjues të ndryshëm. Në tekstin b. referenti është kënga malësore e jugut, në tekstin e. referenti e specifikon fushën semantike dhe është kënga për liri.

¹² Cituar nga Sadikaj, G., Vështrim krahasues mbi veçantitë leksiko-semantike në disa vepra në prozë të I. Kadaresë në variantet shqip dhe

përmbliidhen në një imazh të vetëm). Kjo marrëdhënie formëzohet me anë të gjuhës. Për ta bërë këtë duhet të kuptojmë se kemi pesë makroshenja dhe një shenjë të vetme që do t'i përcaktojë ato. Katër nga makroshenjat: a), b), c), e), në dukje të pavarura, në fakt formojnë një sistem nënbashkësisht kuptimore (brenda bashkësisë d), i cili referon dijen jogjuhësore dhe duke iu referuar Schippan-it¹³, krijojnë një madhësi pragmatike.

1. Sintagma *shqipen pleqërishte*, brenda thënies¹⁴ d) krijon antonimi kontekstuale me sintagmën *çudia e mosfjalosur*. Ky ndajshim plotëson në njëkohësi të dyja elementet e sintagmës së parë: *çudi e mosfjalosur* i shton një tjetër komponent kuptimor shenjës *pleqërishte*.

2. Ndërsa me shenjën *këngë*, sintagma e krijuar te thënia c), e plotësuar me ekspansionin që realizohet nëpërmjet fjalisë ndajshimtare (*ti vjershë e vendit tem*) e drejton vargun lart dhe plotëson efektin eufonik.

3. Thënia a) (*folja jonë pleqërishte*) kodin e ri e bën më të dukshëm, duke e përfshirë fjalën më lart kuptimisht, por më ulët nga niveli ligjërimor, për shkak se sintagma kryefjalore plotëson dy kallëzues homogjenë që shprehin dhimbje, shqetësim (*lëngon e nis të shembet*) për dëmin që po i shkaktohet gjuhës shqipe.

4. Proces tërësisht i kondensuar ndodh në thënien b), në të cilën sintagma (*ligjërata pleqërishte*) funksion si një stacion i ngjirë në thënie, duke mbledhur tërë ngjyrimet imazherike që

gjermanisht Shih: Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenartssprache*. Niemeyer, 1992 (burim i cituar).

¹³ Cituar nga Sadikaj. G, Vështrim krahasues mbi veçantitë leksiko-semanticke në disa vepra në prozë të I.Kadaresë në variantet shqip dhe gjermanisht Shih, Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenartssprache*. Niemeyer, 1992. (burimi cituar)

¹⁴ Duam të qartësojmë se pavarësisht nga vlerat poetike, në vështrimin tonë vargjet do të trajtohen si thënie, për shkak të vlerësimeve pragmatike dhe detajimit të strukturave kuptimore që ato përcjellin në saje të fjalëformimit.

përcjellin segmentet shenjuese¹⁵ të kryefjalës *gjuhë*.

5. Në thënien e) për të shkuar te sintagma *këngë pleqërishte*, poeti duket se e merr me nge: shtron udhë me përdorimin e polisidentit, i cili ngadalëson ritmin (*e, si, pasi*); krijon pritshmëri në vetëdijen e lexuesit nëpërmjet tri fjalive të varura kohore; ndërton shkallëzim zbritës nëpërmjet foljeve (*ra – shkoi – s'kishte zë*); realizon në këtë mënyrë situatën pragmatike dramatike; atëherë gjithë kjo ngarkesë peshon mbi sintagmën *këngë pleqërishte*, duke krijuar referentin e saj: këngën për liri.

Bashkësia semantike-mëmë e sintagmës *shqipe pleqërishte*, gjallon brenda saj pjesët përbërëse të një akti të tërë komunikimi aktiv, në dinamikën e tij më të lartë komunikuese: *e folura, ligjërimi, kënga*, dhe kjo e fundit në formatet e saj: tingëllore (isoja) dhe stigmatizuese (vetëdije patriotike). Skematikisht do të kishim një bashkësi me katër nënbashkësi. Kjo analizë na ndihmon që të kuptojmë peshën semantike dhe emotive të shenjës (*pleqërishte*) që plotëson në njëkohësi secilën prej makroshenjave veçmas, por edhe skemën konjitive që krijohet në hapësirën imazherike të lexuesit, pasi e ka përcjellë gjithë këtë madhësi pragmatike në vetëdijen e tij si marrës i mesazhit poetik.

¹⁵ Kur themi segmente shenjuese, referojmë marrëdhëniet kombinatorike që cilëson lidhja e kryefjalës me pjesët e tjera të fjalisë brenda pjesës kryesore, por edhe në fjalinë e varur. Këto marrëdhënie në fakt reagojnë dinamikën emotive të shenjës *gjuhë*, e cila vjen në rritje si ngarkesë kuptimore (përcaktorët njëri pas tjetrit), por kontekstualizohet në realitete politike (fjalja e varur filluese).

Pleqërishte




Figura 1. Aspekti përcaktues i shenjës

Sipas Klix-it¹⁶ dija njerëzore përbëhet nga konceptet dhe lidhjet e vendosura midis tyre. Kjo dije shkëmbehet me anë të gjuhës. Kjo është e mundur, pasi në kujtesë konceptet lidhen me fjalët përkatëse, që emërtojnë (shenjojnë) cilësitë e një koncepti. Koncepti që përcjell shenja pleqërishte lidhet me tërësinë semantike të bashkësive që ne analizuam, veçse sema nga ku u zhvillua leksema është pleq. Sipas Xh. Lloshit, përbërësit tingullorë, anët e sistemit tingullor dalin në dukje duke ndërthurur fjalët e gjymtyrët e fjalive që të bëhen të perceptueshme këto anë për efekt shprehës dhe sidomos për bukurtingëllim e muzikalitet¹⁷. Kjo përlligje e profesor Xh. Lloshit, na hap udhë të shpjegojmë misionin diskursiv të prapashtesës *-isht*. Prapashtesa *-isht* e ka kodifikuar shumësin pleq, duke ia sfumuar caqet kuptimore dhe duke ia delimituar ngarkesat emotive. Të ngarkosh semantikisht fjalën pleq, do të thotë t’ia shumëfishosh valencën kuptimore që

¹⁶ Cituar nga Sadikaj, G., Vështrim krahasues mbi veçantitë leksiko-semantike në disa vepra në prozë të I. Kadaresë në variantet shqip dhe gjermanisht: Klix, F., *Über Wissensrepräsentation im menschlichen Gedächtnis*. In: Gedächtnis – Wissen – Wissensnutzung. Berlin, 1984, f. 9-73, këtu f. 9.

¹⁷ Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas 2005, f. 57.

ajo në rrënjë e ka të zgjeruar. Në mendësinë shqiptare, fjala *pleq* nuk lidhet ngushtësisht me moshën, porse pikërisht nga moshja starton një seri leksemash që përcaktojnë statuse sociale (*ku vendi i pleqve*), morale (*fjala e plakut do dëgjuar*), politike, por që në zanafillë janë në fakt morale (*kryeplaku*), estetike (*ka mendje plaku*) dhe skajshmërisht emotive (*ku je mor plak; hyri në derë plaku; u bëfsh plak e pleqnofsh; plak për marak; sa rrofsh, pleqnofsh* etj.). Madje edhe vetë Poradeci e nënvizon vlerën e fjalës *plak*, në vargjet: *Të kam shok nga kohë e vjetër / shok prej zemre edhe prej gjaku / shok të ri me besë plaku / nuku kam, nuku ke tjetër*. (“Zemra e shokut”). Shenja gjuhësore (*plak / pleq*) ka qerthullin e saj kuptimor dhe lidhjesor, i cili në marrëdhënie kombinatorike¹⁸ derivon kumte që në kontekste të caktuara (thënie poetike) emetojnë vlera emotive në përputhje me statuset që specifikuam. Duke marrë prapashtesën *-isht*, realizohen asosacione kuptimore dhe figurative, të cilat e çlirojnë shenjën mëmë nga varësia e veçuar e secilit prej statuseve kuptimore që ne përmendëm dhe e nisin fjalën e re drejt epërsive kuptimore, dukuri e cila mbështetet edhe nga epërsitë eufonike. Prapashtesa nis dhe mbaron me zanore, mes të cilave janë dy bashkëtingëllore të shurdhëta. Nëse analizojmë falën e re që krijohet, vërejmë se kemi katër bashkëtingëllore të shurdhëta (*p, q, sh, t*), dy bashkëtingëllore të zëshme (*l, r*), plus katër zanore (*e, ë, o, e*) dhe theks parafundor.




Figura 2: Diagrami i tonalitetit të fjalës *pleqërishte* (efekti eufonik)

Ky kompozim realizon efektin eufonik të fjalës së re, e cila

¹⁸ Me marrëdhënie kombinatorike kuptojmë marrëdhëniet sintaksore në të cilat hyn fjala, në saje të të cilave realizohen përftesa ligjërimore në përputhje me kontekstet e caktuara.

falë prapashtesimit dominohet nga tingujt ngjitës. Nëpërmjet aftësisë depërtuese të tingullit, mbiemri i ri i imponohet lexuesit, duke transferuar në fjalën e re sidomos aftësinë e prapashtesës *-isht* për të zgjeruar dhe përcaktuar cilësinë që mbiemri bart. Aftësitë sigmatike të fjalës së re të krijuar lidhen ngushtësisht me mendësinë e pritësit, sikurse edhe procesi poetik varet nga tipologjia e lexuesit. Në rastin tonë fjala e re e krijuar shkon te lexuesi shqipfolës duke dialoguar me kuptimin, të cilin e zhvillon në fusha semantike tërësisht shqipe (*ngushtësisht, vëllazërisht, bashkarisht* etj.) që cilësojnë gjallime autentike, tradicionale, tipike etj., shkurt, mënyrë tipike shqiptare, shqipërisht. Mbiemri i ri i krijuar bashkon në një të vetme gjithë statuset që mbartte fjala *pleq*, imazhi mendor i të cilit referon në ndërgjegje vetitë e shumësisë së tipareve të shqiptarëve (*mënyrë shumë cilësore ekzistence: moral i lartë, mençuri, bukuri, vlerë, dinjitet* etj.), marrëdhënien e këtyre vetive me realitetin – *kumtet e thënieve* a), b), c), d), e).

Te *Këngë pleqërishte* na shfaqet edhe një variant tjetër shejues: *pleqërish* (f. 63): *Dëgjoju as dëgjoju! Moj këngë pleqërish*. Sikurse shihet, variacioni fonetik (rrudhja fonetike e prapashtesës) realizon një përftesë e cila jo vetëm ka ndryshuar klasë, por edhe ka realizuar një marrëdhënie segmentore shenjuese, të ndryshme me mbiemrin *pleqërishte*. I vendosur brenda një fjalie mungesore, i paraprirë nga pjesëza *moj*, i përmbyllur me efektin eufonik, emri *pleq* është qendra e kuptimit të thënies dhe ngjyrimet që këto marrëdhënie segmentore i japin, e bëjnë më të butë, më të ndjeshëm, gjë që reflekton edhe në tonalitetin e vargut.

Emri *pleqërish*, i krijuar me prapashtesën *-ish*, e ka më të prekshëm dialogimin e kuptimit me tingullin, sepse bashkëtingëllorja *-t* e munguar shoqëron disa ndryshime të strukturës së shenjës: lëvizje të theksit, ndryshim të klasës së fjalëve dhe padyshim riformaton funksionin e saj përcaktues, të cilin nëse e shohim në raport me mbiemrin *pleqërishte*, e gjejmë më të limituar në statuset që përcjell. Nëse mbiemri i shtyn kufijtë kuptimorë me asosacione shenjuese që varen edhe nga tipologjia e lexuesit, emri ka konkretësi dhe i rrudh ato në një

grup të caktuar individësh, të cilët *domosdoshmërisht* i bashkon kriteri i moshës.

Për ta përmbledhur, zanafilla tingullore e prapashtesës, nga e cila rrjedh përftesa e re kuptimore, në secilin rast përmban abstraktin semantik popullor të fjalëve të reja të formuara nëpërmjet një rruge moderne, e cila sintetizon nocione të kristalizuara tashmë në ndërgjegjen shqipfolëse; nëpërmjet prapashtesës konceptet u nënshtrohen proceseve konjitive të bashkëshoqërimit (aspekti sigmatik - përcaktues), vendosen në lidhje të reja kuptimore, në gjedhe krejtësisht shqipe.

Si një vijimësi e kësaj fjale, e këtij formati fjalëformues, e kësaj hapësire kuptimore vijnë edhe fjalët *stërgjyshërishte*, *armiqërishte*, *miturishte*, *shokërishte*, *gjeratorisht*, *lavdërisht*, *nusërisht*, *qiellorisht*, *tmerrësisht*, *virgjërisht* etj.¹⁹

Përfundime

E gjithë metoda fjalëkrijuese e Poradecit mbështetet në dialogimin e tingullit me kuptimin.

Në korpusin poetik të poetit gjejmë fjalëkrijime në të cilat janë shfrytëzuar të gjithë mekanizmat fjalëkrijues të gjuhës shqipe, duke na sjellë kryesisht fjalëkrijime kombinatorike, po jo në pak raste edhe fjalëkrijime semantike.

Nga sa analizuam, arrijmë në përfundimin se poeti ndërton fjalë dhe stilema duke shfrytëzuar abstraktin popullor, por duke ua nënshtuar atë rrugëve moderne.

Fjalëkrijimi i Pradecit aq ngushtësisht i lidhur me synimet e tij mbi pasurimin dhe pastërtinë e gjuhës shqipe, mendojmë se ka lidhje të forta reflektive simbolike ndaj krijimtarisë fjalëkrijuese të Naimit Frashërit, poet të cilin ai e vlerësoi veçanërisht për ndihmesën në pastërtinë e gjuhës shqipe.

¹⁹ Armiqërishte - f. 70; miturishte - f. 183, 328; stërgjyshërishte - f. 68; shokërishte - f. 230; çmendurisht - f. 93; dashurisht - f. 334; dhembshurisht - f. 47, 48, 73, 130, 136, 167; gjeratorisht - f. 130; lavdërisht - f. 332, 332; madhërisht - f. 181; nusërisht - f. 334; qiellorisht - f. 332; tmerrisht - f. 82, 93; tmerrësisht - f. 222; virgjërisht - f. 328.

BIBLIOGRAFI

- Galdi, L. *Introduzione alla stilistica italiana*, Patron Editore, Bologna, 1984.
- Gjikaj, E. *Cikli filozofik në sistemin poetik të Lasgush Poradeci*, Zambaku botime, Tiranë, 2014.
- Hamiti, S. *Vdekja e nositit*, Parathënie, Rilindja, Prishtinë, 1978.
- Kundera. M. *Testamentet e tradhëtuar*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2011.
- Kuteli, M. *Poeti Lasgush Poradeci*, Vëzhgim kritik. 1937.
- Poradeci, L. *Vepra letrare*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1990.
- Lloshi, Xh. *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Albas 2005, f. 57.
- Plangarica, T. *Shkenca e ligjërimit dhe teksti poetik*, INALCO 2017.
- Qosja. R. *Dialogje me shkrimtarë*, Rilindja, Prishtinë, 1979.
- Sadikaj, G. *Vështrim krahasues mbi veçantitë leksiko-semantike në disa vepra në prozë të I. Kadaresë në variantet shqip dhe gjermanisht* Shih, Schippan, Thea, *Lexikologie der deutschen Gegenärtssprache*. Niemeyer, 1992 (burim i cituar).
- Topçiu, L. *Tekstualizim dhe stil*, Getic, Bukuresht, 2003.
https://sq.wikipedia.org/wiki/Gjuha_shqipe